

VENDIM
Nr. 705, datë 12.10.2016

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR
KONFIDENCIALITETIN DHE SIGURINË E INFORMACIONIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS
SË POLICISË EVROPIANE (EUROPOL)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
MBI KONFIDENCIALITETIN DHE SIGURINË E INFORMACIONIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS SË
POLICISË EVROPIANE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Zyra e Policisë Evropiane (më poshtë të quajtura “Palët”),

duke marrë në konsideratë që Palët kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunuese në mënyrë që të mbështesin shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Republikën e Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe format e tjera të krimit ndërkombëtar duke lidhur një Marrëveshje mbi Bashkëpunimin Operacional, më 9 dhjetor 2013 (më poshtë e quajtur “Marrëveshja”);

të vetëdijshëm për nevojën për të mbrojtur dhe ruajtur informacionet, si informacionin e klasifikuar, edhe të paklasifikuar, të shkëmbyer ndërmjet palëve në bazë të Marrëveshjes,

duke marrë në konsideratë nenin 19 të Marrëveshjes, i cili kërkon që Palët t’i përmbahen standardeve specifike të konfidencialitetit;

duke marrë në konsideratë nenin 20 të Marrëveshjes, i cili kërkon që Palët të zbatojnë parimet e përcaktuara në nenin 19 të Marrëveshjes duke lidhur një Memorandum Mirëkuptimi, i cili do të përfshijë, në veçanti, dispozitat mbi organizimin e sigurisë së palëve, edukimin dhe trajnimin, standardet e shqyrtimit të sigurisë, tabelën e ekuivalencës, trajtimin e informacionit të klasifikuar dhe vlerat e sigurisë së informacionit,

duke marrë në konsideratë se shkëmbimi i informacionit të klasifikuar është i kushtëzuar me hyrjen në fuqi të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit mbi konfidencialitetin,

Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është të rregullojë mbrojtjen e informacionit të shkëmbyer ndërmjet Palëve, të cilat zbatojnë parimet e përshkruara në nenin 19 të Marrëveshjes.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të këtij aneksi:

- a) “informacion” nënkupton njohuri, të cilat mund të komunikohen në çdo formë dhe mund të përfshijë të dhënat personale dhe/ose jopersonale;
- b) “informacion i klasifikuar” nënkupton çdo informacion të caktuar, i cili kërkon mbrojtje nga zbulimi i paautorizuar që është caktuar nga një shenjë klasifikimi;
- c) “nivel i klasifikimit” është një shenjë sigurie që shënohet në një dokument që tregon masat e sigurisë, të cilat duhet të zbatohen për informacionin;
- d) “sistem i informacionit” nënkupton të gjithë infrastrukturën, organizimin, personelin dhe komponentët teknikë për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, transmetimin, shfaqjen, shpërndarjen, transferimin dhe fshirjen e informacionit në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
- e) “vlerësim i rrezikut” nënkupton një proces të strukturuar për shqyrtimin e kërcënimeve ndaj sigurisë së informacionit, dobësive dhe ndikimeve në biznes nëpërmjet humbjes së konfidencialitetit, integritetit ose disponueshmërisë së informacionit ose një sistem informacioni, në mënyrë që të përcaktojë nëse kontrollet shtesë të sigurisë janë të nevojshme;
- f) “akreditim” nënkupton procesin e kryer, me qëllim marrjen e një sigurie që të gjitha masat e duhura të sigurisë janë zbatuar dhe se një nivel i mjaftueshëm i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar dhe të sistemit të informacionit është arritur në përputhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi. Procesi i akreditimit përcakton nivelin maksimal të klasifikimit të informacionit që mund të trajtohet në një sistem informacioni, si dhe termat dhe kushtet përkatëse.
- g) “incidentet e sigurisë” nënkuptojnë një ose një seri ngjarjesh të papritura ose të padëshiruara të sigurisë së informacionit që kanë probabilitet të konsiderueshëm për të cenuar operacionet e biznesit dhe për të rrezikuar sigurinë e informacionit;
- h) “auditim” nënkupton një proces të strukturuar të shqyrtimit, rishikimit, vlerësimit dhe raportimit mbi përdorimin e informacionit ose informacioni i sistemit nga një ose më shumë persona kompetentë, të cilët janë të pavarur nga situata, sistemi, procesi, funksioni etj., që është subjekt auditimi.

KAPITULLI 1 KONFIDENCIALITETI

Neni 3 **Parimet**

Secila Palë duhet:

1. Të mbrojë dhe të ruajë informacionin e paklasifikuar, i cili i nënshtrohet Marrëveshjes dhe këtij Memorandumi Mirëkuptimi, me përjashtim të informacionit që është shënuar shprehimisht apo që njihet qartë si informacion publik, nga masa të ndryshme, duke përfshirë detyrimin e konfidencialitetit dhe diskrecionit, duke kufizuar aksesin për personelin e autorizuar dhe masat e përgjithshme teknike dhe procedurale;
2. Të mbrojë dhe të ruajë informacionin e klasifikuar në bazë të Marrëveshjes dhe këtij Memorandumi Mirëkuptimi siç do të përcaktohet më poshtë.

Neni 4 **Struktura e sigurisë**

Secila Palë duhet të garantojë që ka një organizatë, strukturë dhe masa sigurie në vend. Palët duhet të garantojnë që:

1. Struktura e sigurisë të përmbajë role të përcaktuara me përgjegjësinë për sigurinë e shtresave të ndryshme hierarkike;
2. Të jenë identifikuar zotëruesit e informacioneve me vlerë;
3. Të jetë identifikuar/vendosur një autoritet i caktuar, përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të informacionit;
4. Të jetë identifikuar/vendosur një autoritet i caktuar, përgjegjës për akreditimin e sistemit të

informacionit, i cili trajton informacionin e klasifikuar në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi;

5. Të jetë identifikuar/vendosur një autoritet i caktuar, përgjegjës për sigurinë e informacionit në formë elektronike;

6. Të jetë identifikuar/vendosur një autoritet i caktuar, përgjegjës për trajtimin e materialit kriptografik, nëse është përdorur.

Neni 5

Edukimi, trajnimi dhe ndërgjegjësimi

Secila Palë duhet të garantojë që i gjithë stafi, i cili përpunon informacionin në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, të njihet me kuadrin e sigurisë në përgjithësi dhe të jetë i vetëdijshëm për procedurat e raportimit të çështjeve që lidhen me sigurinë. Ata duhet të garantojnë më tej se stafi, i cili menaxhon dhe siguron konfigurimin e sigurt të sistemit të informacionit dhe ata të cilët kanë akses ndaj informacioneve me vlerë të jenë të trajnuar siç duhet dhe të jenë të vetëdijshëm për procedurat e raportimit të incidenteve.

Neni 6

Shqyrtimi i sigurisë dhe autorizimet

Secila Palë duhet të garantojë, që:

1. Të gjithë personat të cilët në përmbushje të detyrave të tyre zyrtare, kërkojnë akses apo funksioni dhe detyra e të cilëve i jep të drejtën e aksesit ndaj informacionit të klasifikuar, duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit bazë të sigurisë;

2. Të gjithë personat të cilët për arsye të detyrave të tyre zyrtare kërkojnë akses apo funksioni dhe detyra e të cilëve i jep të drejtën e aksesit ndaj informacionit të klasifikuar si KONFIDENCIAL të BE-së në përmbajtje të këtij Memorandumi Mirëkuptimi apo në një nivel klasifikimi më të lartë, të autorizohen në mënyrë të përshtatshme mbi sigurinë e tyre përpara se t'u jepet akses ndaj këtij informacioni;

3. Procedurat e autorizimit të sigurisë të planifikohen për të përcaktuar nëse një individ, duke marrë në konsideratë besueshmërinë, besnikërinë dhe sigurinë e tyre, ka akses tek informacioni i klasifikuar;

4. Të rishikohet rregullisht e drejta e vazhdueshme e një individi për akses tek informacioni i klasifikuar.

Neni 7

Zgjedhja e nivelit të klasifikimit

1. Secila palë është përgjegjëse për zgjedhjen e nivelit të duhur të klasifikimit për informacionin e dhënë për Palën tjetër.

2. Nëse secila palë, mbi bazën e informacionit tashmë në zotërim të tij, arrin përfundimin se për zgjedhjen e nivelit të klasifikimit nevojitet një ndryshim, ajo duhet të informojë Palën tjetër dhe të përpaket për të rënë dakord mbi një nivel të përshtatshëm klasifikimi. Asnjëra palë nuk duhet të përcaktojë apo ndryshojë një nivel klasifikimi të informacionit pa pëlqimin me shkrim të Palës tjetër.

3. Secila palë mund të kërkojë në çdo kohë një ndryshim të nivelit të klasifikimit në lidhje me informacionin që ka dhënë, duke përfshirë një heqje të mundshme të një niveli të tillë. Pala tjetër do të ndryshojë nivelin e klasifikimit në përputhje me këto kërkesa. Çdo Palë, sa më shpejt që e lejojnë rrethanat, duhet të kërkojë që niveli i klasifikimit të ulet ose të hiqet krejtësisht.

4. Secila Palë mund të përcaktojë periudhën kohore për të cilën duhet të aplikohet zgjedhja e nivelit të klasifikimit, në lidhje me informacionin që ka dhënë dhe çdo ndryshim të mundshëm të nivelit të klasifikimit, pas një periudhe të tillë.

5. Kur informacioni nga i cili është ndryshuar niveli i klasifikimit në përputhje me këtë nen, i jepet palëve të treta, të gjithë marrësit do të informohen për ndryshimin e nivelit të klasifikimit.

Neni 8

Tabela e ekuivalencës

Palët përcaktojnë se nivelet e mëposhtme të klasifikimit sipas legjislacionit kombëtar të Republikës së Shqipërisë dhe nivelet e klasifikimit të përdorura brenda Europolit janë ekuivalente dhe do të sigurojnë mbrojtje të njëjtë të informacionit të shënuar me një nivel të tillë klasifikimi:

Për Republikën e Shqipërisë	Për Europol
“I KUFIZUAR”	“RESTREINT UE/EU RESTRICTED /I KUFIZUAR I BE-së”
“KONFIDENCIAL”	“CONFIDENTIEL UE/ EU CONFIDENTIAL/ KONFIDENCIAL I BE-së”
“SEKRET”	“SECRET UE/EU SECRET/SEKRET I BE-së”
“TEPËR SEKRET”	“TRÉS SECRET UE/EU TOP SECRET/TEPËR SEKRET I BE-së»

Neni 9

Regjistrimi

Çdo Palë do të regjistrojë të gjithë informacionin e klasifikuar si CONFIDENTIEL UE/ EU CONFIDENTIAL/ KONFI-DENCIAL I BE-së dhe në një nivel klasifikimi më të lartë ose ekuivalentin e tij në Republikën e Shqipërisë në regjistrin e saj. Informacioni i regjistruar duhet të jetë të paktën minimumi i nevojshëm për të identifikuar në mënyrë unike informacionin në fjalë, si për shembull, numrin e tij të referencës, lëndën, datën dhe nivelin e klasifikimit.

Neni 10

Shënjimi

Çdo Palë duhet të garantojë që informacioni i klasifikuar në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi të shënjohej gjithmonë qartë me anë të emërtimeve të përcaktuara në nenin 8, në mënyrë që të lejojë njohjen e nivelit të klasifikimit.

Neni 11

Ruajtja

I gjithë informacioni i klasifikuar në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, do të ruhet në një mënyrë të sigurt që t'i korrespondojë kuadrit përkatës ligjor të Palës.

Neni 12

Riprodhimi dhe përkthimi

1. Secila Palë duhet të garantojë që numri i riprodhimeve të informacionit të klasifikuar të jetë i kufizuar në masën që është rreptësisht e nevojshme për të përmbushur kërkesat thelbësore. Masat e sigurisë të zbatueshme për informacionin origjinal, gjithashtu, do të jenë të zbatueshme për riprodhimin e tij.

2. Secila Palë duhet të garantojë që të gjitha riprodhimet individuale të informacionit të klasifikuar CONFIDENTIEL UE/ EU CONFIDENTIAL/KONFIDENCIAL I BE-së dhe në një nivel klasifikimi më të lartë ose ekuivalentet e tij në Republikën e Shqipërisë të mbajnë një numër unik që lejon identifikimin e secilit riprodhim individual të informacionit.

3. Riprodhimet në tërësi ose në pjesë të informacionit të klasifikuar TRÉS SECRET UE/EU TOP SECRET/TEPËR SEKRET I BE-së ose ekuivalentin e tij në Republikën e Shqipërisë nuk do të bëhen pa pëlqimin paraprak me shkrim të autorit, i cili mund të përcaktojë kufizime të tjera.

4. Të gjitha përkthimet e informacionit të klasifikuar, për qëllim të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, konsiderohen të jenë riprodhime të informacionit origjinal.

Neni 13

Dërgimi

1. Informacioni i klasifikuar do të dërgohet në mënyrë të sigurt në përputhje me kuadrin ligjor të Palës transmetuese.

2. Informacioni i klasifikuar CONFIDENTIEL UE/ EU CONFIDENTIAL /KONFIDENCIAL I BE-së dhe në një nivel klasifikimi më të lartë, ose ekuivalenti i tij në Republikën e Shqipërisë duhet të shkëmbehet ndërmjet regjistrave përgjegjës të Palëve transmetuese.

3. Dërgimi i informacionit të klasifikuar CONFIDENTIEL UE/ EU CONFIDENTIAL /KONFIDENCIAL I BE-së do të dokumentohet nga regjistrat përgjegjës.

4. Marrja e informacionit të klasifikuar duhet të konfirmohet.

Neni 14

Shkatërrimi

1. Secila Palë duhet të garantojë që informacioni i klasifikuar, i cili nuk është më i nevojshëm, të shkatërrohet me anë të metodave të cilat plotësojnë standardet përkatëse në mënyrë që të parandalojë rindërtimin e plotë ose të pjesshëm.

2. Mbetjet e informacionit të klasifikuar që rezultojnë nga përgatitja e informacionit të klasifikuar do të shkatërrohen duke përdorur të njëjtin kujdes dhe metodë që është përdorur për të shkatërruar informacionin e klasifikuar.

3. Për informacionin e klasifikuar CONFIDENTIEL UE/ EU CONFIDENTIAL /KONFIDENCIAL I BE-së dhe në një nivel klasifikimi më të lartë ose ekuivalentin e tij në Republikën e Shqipërisë, shkatërrimi do të regjistrohet nga regjistri, në përputhje me kuadrin përkatës ligjor të Palës.

Neni 15

Vlerësimet

1. Secila Palë duhet të lejojë Palën tjetër të vizitojë territoret apo ambientet përkatëse nëpërmjet marrjes së një leje me shkrim, në mënyrë që të vlerësohen procedurat dhe mjetet për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të marrë nga Pala tjetër. Masat për vizita të tilla duhet të miratohen në mënyrë të dyanshme. Secila Palë do të ndihmojë Palën tjetër për të konstatuar nëse informacioni i klasifikuar, i cili është vënë në dispozicion nga Pala tjetër, është i mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme.

Neni 16

Cenimi i informacionit të klasifikuar

1. Autoriteti i Sigurimit i njëres Palë njofton menjëherë Autoritetin e Sigurisë së Palës tjetër për çdo cenim të mundshëm të informacionit të klasifikuar.

2. Kur ndodh ndonjë zbulim i paautorizuar, të dyja Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të rregullt për hetimin dhe do të informojnë njëra-tjetrën në lidhje me rezultatet.

KAPITULLI 2

SIGURIMI I INFORMACIONIT

Neni 17

Politika e sigurisë së informacionit

Secila Palë duhet të ketë si përbërës të politikës së tyre gjithëpërfshirëse, një politikë të sigurisë së informacionit, e cila përcakton mënyrën si ata dhe partnerët e tyre të shpërndarjes së

informacionit, pajtohen me kërkesat minimale të përcaktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Neni 18

Menaxhimi i rrezikut të informacionit

Secila Palë do të kryejë rregullisht vlerësimin e rrezikut të informacionit dhe kur ka një ndryshim të konsiderueshëm në një komponent rreziku (kërcënim, cenueshmëri, ndikim etj.) për sistemin ekzistues të informacionit në veprim. Vlerësimi dhe vendimet e marra për menaxhimin e rrezikut do të regjistrohen në dokumentacionin përkatës të Menaxhimit të Riskut.

Neni 19

Akreditimi

Secila palë duhet të garantojë që sistemet e informacionit të klasifikuar, të cilat përpunojnë informacionin e klasifikuar në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi të jenë të akredituara. Statusi i akreditimit do të rishikohet në intervale të rregullta për të gjykuar nëse kanë ndodhur ndryshime materiale, të cilat mund të ndryshojnë vendimin fillestar të akreditimit.

Neni 20

Auditi

Secila Palë duhet të kryejë audite të sigurta për sistemin e informacionit, i cili përpunon informacionin e klasifikuar në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 21

Identiteti dhe menaxhimi i aksesit

Secila Palë duhet të ketë kontrolle të përshtatshme identifikimi dhe vërtetimi për sistemin e informacionit, i cili përpunon informacionin e klasifikuar në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 22

Kriptografia

Secila Palë duhet të përdorë kontrolle kriptografike për shkëmbimin e sigurt të informacionit të klasifikuar në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Pajisjet e kriptografisë duhet të miratohen në përputhje me kuadrin ligjor të Palës transmetuese.

Neni 23

Përgjimi dhe kundërmasat elektromagnetike

Sistemet e informacionit të cilat trajtojnë informacionin e klasifikuar CONFIDENTIEL UE/ EU CONFIDENTIAL/ KONFI-DENCIAL I BE-së dhe në një nivel klasifikimi më të lartë ose ekuivalentin e tij në Republikën e Shqipërisë do të mbrohen në bazë të vlerësimit të rrezikut, në mënyrë të tillë që informacioni të mos rrezikohet nga përgjimi ose burimet elektromagnetike.

Neni 24

Raportimi i incidenteve

Secila Palë duhet të ketë politika dhe procedura të qarta për të raportuar, menaxhuar dhe zgjidhur incidentet dhe shkeljet e sigurisë.

Neni 25

Mjetet e lëvizshme të komunikimit

Secila Palë duhet të ketë politika dhe procedura për përdorimin e duhur dhe mbrojtjen e mjeteve të lëvizshme të komunikimit, të përdorura për të ruajtur informacionin e klasifikuar në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 26

Hedhja e informacionit në mënyrë të sigurt

Secila Palë duhet të sigurojë se të gjitha mjetet e komunikimit, të përdorura për ruajtjen ose përpunimin e informacionit të klasifikuar, duhet të hidhen në mënyrë të sigurt ose të fshihen në përputhje me kuadrin përkatës ligjor të Palës pjesëmarrëse.

KAPITULLI 3

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas njoftimit të Palës shqiptare, që ka përfunduar procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të Memorandumit.

Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar do të bëhet vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 28

Amendimi dhe përfundimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet me shkrim, në çdo kohë, me pëlqimin reciprok ndërmjet Palëve.

2. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të përfundohet me shkrim nga secila prej Palëve me një njoftim tre muaj para. Në këtë rast, efektet ligjore të këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të mbeten në fuqi.

3. Ky Memorandum Mirëkuptimi ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të Marrëveshjes.

Nënshkruar në Tiranë/Den Haag, më _____, në dy kopje në gjuhën shqipe dhe angleze, ku secili tekst është njëlloj autentik. Në rast mosmarrëveshjeje për interpretimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të merret parasysh varianti në gjuhën angleze.

Për Këshillin e
Ministrave të
Republikës së
Shqipërisë:
Saimir Tahiri

Për Europol:
Rob Wainwright
Director